

# NEWSLETTER E DIASPORËS


PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,  
DUKE NXITUR E FUGIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRIE DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#18

## Miratohet personi përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë miratoi urdhrin për "Ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të emigrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare". Ky urdhrë është lëshuar në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutit, të pikës 1, të nenit 12, të Ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". Sipas këtij urdhri, grupi i punës do të përbëhet nga Zv.ministri i Drejtësisë, znj. Floraba Cakaj, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe nga Ministri i Shtetit për Diasporën.

Qëllimi i krijimit të këtij grupi pune është koordinimi i punëve ndërinstitucionale për mbledhjen e informacionit të plotë, për ndjekjen dhe trajtimin sipas legjislativimit në vendet pritëse të shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit. Krijimi i grupit të punës është në përputhje me masat 24 dhe 44 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën. Raportimi i punës së këtij grupi do të bëhet çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.



## Takimi i parë i Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën

Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë sot në mbledhjen e parë të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën, i cili është ngritur në bazim të marrëveshjes midis dy shteteve "Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë". Në fjalën e tij ministri i Shtetit për Diasporën u shpreh se çështja e arsimit në Diasporë është një sfidë më vete, por hartimi i këtij komisioni dhe bashkëpunimi mes dy palëve do ta kalojë këtë sfidë duke arritur në një rezultat në ndihmë të mësimin të gjuhës dhe kulturës shqipe në Diasporë. Qendra e Botimeve për Diasporën ka për qëllim koordinimin e punës së këtij komisioni si dhe të fokusohet në mbështetjen me botime plotësuese për komunitetin shqiptar në Diasporë.

Gjatë kësaj mbledhjeje u zgjodh kryetari i komisionit z. Nuh Gashi, përfaqësues për mësimin plotësues në Diasporë pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës si dhe u vendos për hartimin e një rregulloreje të përbashkët midis dy vendeve, me qëllim miratimin e teksteve të përbashkëta për Diasporën shqiptare. Pjesë e këtij komisioni janë përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Shqipërisë si dhe nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës.



## FSHZHD dhe QBD takohen me Shoqatat e Grave në Selanik



Në kuadër të Festivalit të Shumëgjuhësisë që u zhvillua në Selanik, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës si dhe Qendra e Botimeve të Diasporës realizuan një takim me shoqatat e grave në Selanik. Ky takim pati synim njohjen me rrjetin e grave, punën e bërë si dhe çështje të tjera me qëllim mbështetjen e iniciativave të tyre në Greqi, forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe angazhimin e këtij rrjeti në projektet e ndryshme dedikuara Diasporës shqiptare. Takimi u krye në ambientet ku zhvillohet mësimi i gjuhës shqipe nga shoqata "Nënë Tereza" pranë Universitetit Aristotei, Selanik.

## Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare për Diasporën vizitë në komunitetin arbëresh në Chieuti

Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare për Diasporën vizitë në komunitetin arbëresh në Chieuti. Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare për Diasporën znj. Etleva Kondi mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të bustit të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu në komunën e Chieuti, Itali. Ajo përgëzoi punën e komunitetit arbëresh për të ruajtur vlerat kombëtare tek brezat e rinj. E veçanta të kësaj dite është edhe botimi i abetares në gjuhën arbëreshe nga studiuesi Prof. Mario Massaro në bashkëpunim me znj. Ariana Balluku. Gjatë këtij aktiviteti, një grup nxënësish të shkollës shqipe "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" interpretuan këngë dhe valle me motive arbëreshe. Në komunën e Chieuti-it, arbëreshët kanë formuar komunitetin e tyre nga gjysma e shekullit XV.



## FSHZHD dhe QBD marrin pjesë në edicionin e VII të Festivalit të Shumëgjuhësisë në Selanik

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve të Diasporës morën pjesë në edicionin e VII të Festivalit të Shumëgjuhësisë në Selanik, Greqi. Në këtë festival, këto dy institucione prezantuan politikat shtetërore të hartuara për Diasporën si dhe punën e tyre me qëllim përkrahjen dhe ngritjen e urave të bashkëpunimit me komunitetin shqiptaro-grek.

